

Член 26

Подзаконскиот пропис предвиден во членот 14 од овој закон ќе се донесе во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 27

Постапките за посвојувањето започнати пред денот на влегувањето во сила на овој закон ќе продолжат според одредбите на овој закон.

Член 28

Центарот за социјална работа во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон, ќе изврши внесување на податоците во Програмата за сите лица запишани во регистарот на можни посвоители и во регистарот на можни посвоеници.

Член 29

Министерството за труд и социјална политика во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон ќе направи внесување на потребните податоци за започнување со работа на Програмата.

Член 30

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR FAMILJE

Neni 1

Në Ligjin për familje ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 80/92, 9/96, 38/2004, 33/2006 dhe 84/2008), në nenin 27 paragrafi 1 pas fjalës "martesë" shtohen fjalët: "anëtarit të Këshillit të Komunës që ai do ta përcaktojë".

Neni 2

Në nenin 29 paragrafi 3 pas fjalëve: "Pasi që" shtohen fjalët: "anëtari i Këshillit të Komunës".

Në paragrafin 4 në rreshtin e katërt pas fjalës "bashkëshortët" shtohen fjalët: "anëtari i Këshillit të Komunës".

Në paragrafin 6 pas fjalës "bashkëshortët" shtohen fjalët: "anëtari i Këshillit të Komunës".

Neni 3

Në nenin 94-z në paragrafin 2 pas fjalës "punë" shtohet presje dhe fjalët: "përkatësisht viktima e dhunës familjare".

Neni 4

Në nenin 97-a paragrafi 1, fjala "pesë" zëvendësohet me numrin "15".

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Komisioni nga paragrafi 1 i të këtij neni, punon në përbërje prej pesë anëtarësh të cilët zgjidhen në ditën e mbajtjes së çdo mbledhjeje në mënyrë elektronike nga të gjithë anëtarët e Komisionit".

Paragrafi 2 i cili bëhet paragraf 3, ndryshohet si vijon:

"Anëtar i Komisionit mund të bëhet personi i cili ka arsim të lartë dhe përvojë pune prej së paku pesë vitesh në sferë."

Në paragrafin 3 i cili bëhet paragraf 4, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: "të cilët përvojën e punës kanë arritur në sferë."

Në paragrafin 4 i cili bëhet paragraf 5, fjala "pesë" zëvendësohet me fjalën "dy".

Paragrafi 6 i cili bëhet paragraf 7, ndryshohet si vijon:

"Kryetari i Komisionit zgjidhet nga anëtarët e Komisionit në mënyrë elektronike në ditën e mbajtjes së çdo mbledhjeje".

Paragrafët 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 bëhen paragrafë 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, dhe 10.

Neni 5

Titulli para nenit 100-a, ndryshohet si vijon:

"Kushtet dhe kriteret për adoptim".

Në nenin 100-a pas paragrafit 4 shtohen dy paragrafë të rinj 5 dhe 6, si vijojnë:

"Zgjedhja e adoptuesit do të varet nga kriteret si vijojnë:

- gjendja shëndetësore,
- statusi psikosocial,
- kushtet materiale,
- kushtet banesore,
- koha e pritjes,
- shkalla e arsimit
- statusi martesor dhe
- shtetësia.

Kriteret më të afërta për zgjedhjen e adoptuesit nga paragrafi 5 i këtij neni, i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale".

Neni 6

Pas nenit 101 shtohet neni i ri 101-a, si vijon:

"Neni 101-a

Kur fëmijën e adopton familjari i cili nuk është shënuar në nenin 101 nga ky ligj dhe i cili nuk jeton në territorin e Republikës së Maqedonisë, fëmija mund të adoptohet deri në mbushjen e moshës 12 vjeçare të jetës së fëmijës."

Neni 7

Në nenin 103 paragrafi 4 pas fjalës "fëmijës" shtohen fjalët: "i cili është", pas fjalës "familje" shtohen fjalët: "më shumë se një vit dhe", ndërsa pas fjalës "fëmijën" vihet pikë, ndërsa fjalët deri në fund të fjalisë shlyhen.

Pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri 5, si vijon:

"Qendra për Punë Sociale, në afatin e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, është e obliguar që në çdo dy muaj e së paku tri herë ta thirrë prindin që ta marrë përkujdesjen për fëmijën."

Paragrafët 5 dhe 6 bëhen paragrafë 6 dhe 7.

Neni 8

Në nenin 104 pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

"Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni, dëshiron të adoptojë fëmijë në vende të huaja, pajtueshmëri për atë jep Komisioni, pas propozimit të Qendrës për Punë Sociale në bazë të vlerësimit për përshtatshmërinë e adoptuesit dhe për motivet e adoptimit, në pajtim me nenet 104-b dhe 104-v të këtij Ligji."

Neni 9

Në nenin 104-a pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2, si vijon:

"Në rastet kur parashtruesi i kërkesës është shtetas i huaj, Komisioni e përcakton Qendrën për Punë Sociale, që do të procedojë për kërkesën."

Paragrafi 2 bëhet paragrafi 3.

Neni 10

Në nenin 104-b paragrafi 1 fjala "gjashtë" zëvendësohet me fjalën "katër", ndërsa fjalët: "një vit" zëvendësohen me fjalët: "gjashtë muaj".

Pas paragrafit 1 shtohen tre paragrafë të rinj 2, 3 dhe 4, si vijojnë:

“Kur si parashtrues i kërkesës paraqitet bashkëshorti i prindit të fëmijës, periudha e përcjelljes së vazhdueshme është dy muaj.

Në rast kur si parashtrues të kërkesës paraqiten personat nga nenet 100-b dhe 101-a të këtij ligji, krahas punëve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Ligji, Qendra për Punë Sociale është e obligueshme që t'i konfirmojë edhe shkaqet dhe arsyeshmërinë e adoptimit të këtyllë.

Në rastet nga neni 104-a paragrafi 3 të këtij ligji, Qendra për Punë Sociale ku është dërguar kërkesa, në bazë të këtij dokumenti përgatit konstatim dhe mendim të ekipit profesional dhe jep propozim për regjistrim në regjistrin e adoptuesve të mundshëm.”

Neni 11

Në nenin 104-g paragrafi 1 pas fjalës “ekipit” shtohen fjalët “edhe konstatimet dhe mendimet e posaçme të punëtorëve profesionalë”, kurse fjala “propozim” zëvendësohet me fjalën “propozimin”.

Neni 12

Në nenin 104-d paragrafi 2 pas fjalës “adoptuesve” shtohen dy pika, numri “20” zëvendësohet me numrin “102”, pas fjalës “ligj” vihet presje dhe shtohen fjalët: “nëse parashtruesi i kërkesës e tërheq kërkesën, në rast të lidhjes së martesës apo ndërprerjes së martesës”.

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

“Qendra për Punë Sociale, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit nga paragrafi 2 i këtij neni, e kryen arkivimin e të dhënave për adoptuesin në Programin për zgjedhje të adoptuesit më të përshtatshëm në mënyrë elektronike (në tekstin e mëtejshëm: Programi)”.

Neni 13

Në nenin 104-gj pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

“Qendra për Punë Sociale pas regjistrimit të fëmijës në regjistrin e të adoptuarve të mundshëm, mund të japë pajtueshmëri që kujdestarinë për ndonjë fëmijë të caktuar, ta kryejë ndonjë qendër tjetër për punë sociale. Me dhënien e pajtueshmërisë ndërpriten të gjitha të drejtat dhe obligimet e Qendrës për Punë Sociale, që e ka dhënë pajtueshmërinë.”

Në paragrafin 3 i cili bëhet paragrafi 4 pas fjalëve: “të adoptuar” shtohen dy pika, ndërsa pas fjalës “ligj” shtohet presje dhe fjalët: “për shkak të moshës madhore”.

Pas paragrafit 4 shtohet paragrafi i ri 5, si vijon:

“Qendra për Punë Sociale, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të punëve nga paragrafi 4 i këtij neni, e kryen arkivimin e të dhënave për fëmijën në Program.”

Neni 14

Në nenin 104-z pas paragrafit 1 shtohen katër paragrafë të rinj 2, 3, 4 dhe 5, si vijojnë:

“Qendra për Punë Sociale në afat prej tri ditësh nga pranimi i punëve nga paragrafi 1 të këtij neni, e kryen futjen e të dhënave në Program. Të dhënat e futura në Program, të cilat kanë të bëjnë me emrin personal të adoptuesit, në pajtim me Programin, gjatë zgjedhjes së adoptuesit më të përshtatshëm nga pesë adoptuesit e parë të mundshëm, paraqiten si shifra.

Nëse bëhen ndryshime në kushtet për vendosjen e adoptimit, dorëzuesi i kërkesës është i obliguar që na afat prej shtatë ditësh nga ndryshimi i shkaktuar, për këtë ta informojë Qendrën për Punë Sociale me dorëzimin e dëshmisë përkatëse.

Qendra për Punë Sociale pas marrjes së punëve nga paragrafi 3 i këtij neni, në afat prej 24 orësh e kryen futjen e ndryshimit në Program dhe menjëherë për këtë e informon Komisionin, dhe ia dërgon originalin e dokumentit në bazë të të cilit është kryer ndryshimi.

Futjen e të dhënave në Program, e kryejnë personat zyrtarë të Qendrës për Punë Sociale, të autorizuar nga personi i cili udhëheq me Qendrën për Punë Sociale, dhe të njëjtit përgjigjen për autenticitetin e të dhënave të futura.

Futjen e të dhënave të shfrytëzuesve të shërbimeve (Qendra për Punë Sociale) apo arkivimin e tyre, si dhe futjen apo ndryshimin e të dhënave në bazë të të cilave përcaktohet gjendja materiale e adoptuesit, në Program, e kryen administratori në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe i njëjti përgjigjet për autenticitetin e të dhënave të futura.”

Neni 15

Neni 104-x ndryshohet, si vijon:

“Qendra për Punë Sociale pas pranimit të punëve nga neni 104-z i këtij ligji, e kryen zgjedhjen e adoptuesit më të përshtatshëm, në mënyrë elektronike dhe e informon Komisionin për pesë adoptuesit e parë të mundshëm nga lista e Programit.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, kur si adoptues paraqiten personat nga nenet 100-b, 100-v dhe 101-a të këtij ligji, Qendra për Punë Sociale është e obliguar që Komisionit t'i dorëzojë propozim për vendosjen e fëmijës në familjen e adoptuesit të mundshëm, së bashku me shkaqet e përcaktuara dhe arsyen e adoptimit të këtyllë.

Komisioni pas pranimit të punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, në bazë të dokumenteve dhe të dhënave në Program, e kryen zgjedhjen e adoptuesit më të përshtatshëm. Komisioni obligohet që të paraqesë arsyetimin për zgjedhjen e kryer.

Në rastet nga paragrafi 2 i këtij neni, Komisioni nuk e kryen zgjedhjen e adoptuesit.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale, e përcakton mënyrën e zgjedhjes së adoptuesit në mënyrë elektronike.”

Neni 16

Në nenin 104-i në paragrafin 1 fjalët: “kopje nga shkresat e adoptuesve të mundshëm dhe adoptuesit,” shlyhen, ndërsa pas fjalës “menjëherë” shtohet fjala “e”.

Në paragrafin 2 fjalët: “të dhëna për” dhe “dhe vendi” fshihen, presja pas fjalës “fëmija” fshihet dhe shtohen fjalët: “edhe të dhënat”.

Neni 17

Në nenin 106 pas paragrafit 5 shtohet paragrafi i ri 6, si vijon:

“Nëse prindi i cili jep pajtueshmëri që fëmija të jepet për adoptim është analfabet, deklaratën për pajtueshmëri e jep në formë të procesverbalit në lokalet e Qendrës për Punë Sociale dhe në prani të ekipit profesional të Qendrës për Punë Sociale. Deklaratën e nënshkruajnë prindi i cili në vend të nënshkrimit të deklaratës me shkrim, do ta vendosë gjurmën e gishtit tregues dhe anëtarët e ekipit profesional.”

Pas paragrafit 6 i cili bëhet paragraf 7 shtohet paragrafi i ri 8, si vijon:

“Deklarata regjistrohet në protokoll dhe vërtetohet me vulën e Qendrës për Punë Sociale.”

Neni 18

Pas neni 106 shtohet neni i ri 106-a, si vijon:

“Neni 106-a

Deklarata me shkrim për pajtueshmëri nga neni 106 nga ky ligj, duhet të përmbajë të dhëna për: emrin personal, datën dhe vendlindjen, vendbanimin dhe adresën e vendbanimit, përkatësinë nacionale, numrin unik amë dhe numrin e letërnjoftimit të prindit apo kujdestarit; emrin personal, datën dhe vendlindjen e fëmijës dhe nëse fëmija

është lindur në martesë apo jashtë martesës; pajtueshmërinë që fëmija të adoptohet pa e përcaktuar adoptuesi (përveç kur si adoptues paraqiten personat nga nenet 100-b dhe 101-a të këtij ligji); llojin e adoptimit; shkaqet për të cilat pajtohet që fëmija të adoptohet, si dhe se është i njoftuar me të gjitha pasojat nga dhënia e deklaratës.”

Neni 19

Në nenin 107 paragrafët 1 dhe 2 fjalët: “tre muaj” zëvendësohen me fjalët: “gjashtë javë”.

Neni 20

Në nenin 110 paragrafi 2 pas fjalëve: “aktvendimi për” shtohet fjala “plotësisht”, fjala “adoptimi” zëvendësohet me fjalën “adoptim”, presja pas fjalëve: “i adoptuari” zëvendësohet dhe lidhëzën “dhe”, pas fjalës “fëmijës” shtohet pikë, kurse fjalët deri në fund të fjalisë shlyhen.

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

“Në procesverbalin dhe në aktvendimin e adoptimit jo të plotë, futen të dhënat për llojin e adoptimit të kryer, për marrëveshjen për mbiemrin e të adoptuarit dhe për të drejtat e tij trashëgimore ndaj adoptuesit.”

Paragrafi 3 i cili bëhet 4, ndryshohet si vijon:

“Procesverbalin e nënshkruajnë personi zyrtar nga Qendra për Punë Sociale i cili e përfaqëson fëmijën, prindërit e fëmijës nëse vendoset adoptim jo i plotë, prindi i fëmijës nëse adoptimin e kryen bashkëshorti i prindit të fëmijës, adoptuesi, kryetari dhe personit zyrtar i Komisionit.”

Pas paragrafit 3 i cili bëhet 4 shtohen dy paragrafë të rinj 5 dhe 6, si vijojnë:

“Aktvendimet nga nenet 104-i dhe 110 të këtij ligji, i nënshkruan kryetari i Komisionit.

Me përjashtim nga paragrafi 5 i këtij neni, aktvendimet nga nenet 104-i dhe 110 të këtij ligji, i nënshkruan ministri i Punës dhe Politikës Sociale kur si adoptues paraqitet personi i cili është shtetas huaj.”

Neni 21

Në nenin 111 paragrafi 1 fjala “adoptimi” zëvendësohet me fjalët: “adoptimi i plotë”, ndërsa fjalët: “dhe Komisioni” shlyhen.

Pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, si vijon:

“Pas vendosjes së adoptimit jo të plotë në librin e amzës së të lindurve, regjistrohet mbiemri i fëmijës, që me marrëveshje do ta përcaktojnë adaptuesit dhe shënohet se fëmija është adoptuar në mënyrë jo të plotë.”

Paragrafi 2 bëhet paragrafi 3.

Neni 22

Në nenin 118 paragrafin 1 pas fjalës “Komisioni” shtohen fjalët: “me propozim të Qendrës për Punë Sociale.”

Neni 23

Në nenin 119 pas fjalës “me” shtohen fjalët: “propozim të Qendrës për Punë Sociale, e në bazë të.”

Neni 24

Pas nenit 122 shtohet neni i ri 122-a, si vijon:

“Neni 122-a

Komisioni me kërkesë të adoptuesve dhe me pëlqimin e prindërve apo kujdestarit të fëmijës, i cili është adaptuar në mënyrë jo të plotë dhe fëmijës nëse është më i moshuar se 12 vjet, e me propozimi të Qendrës për Punë Sociale, mund të vendosë që adoptimi në mënyrë jo të plotë të bëhet i plotë.

Adoptimi jo i plotë mund të bëhet i plotë vetëm deri në mbushjen e moshës 18 vjeçare të fëmijës.”

Neni 25

Në nenin 123 pas fjalës “ndërprerje” shtohen fjalët: “apo për ndryshim”.

Neni 26

Dispozita nënligjore e paraparë në nenin 14 të këtij ligji, do të miratohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 27

Procedurat për adoptim të filluara para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 28

Qendra për Punë Sociale në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do ta kryejë futjen e të dhënave në Program, për të gjithë personat e regjistruar në regjistrin e adoptuesve të mundshëm dhe në regjistrin e të adoptuarve të mundshëm.

Neni 29

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do ta kryejë futjen e të dhënave të nevojshme për fillimin me punë të Programit.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

ПРЕТСЕДАТЕЛ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА 1206.

Врз основа на член 84, алинеја втора од Уставот на Република Македонија („Службен весник на Република Македонија“ бр. 52/91), донесувам

У К А З

ЗА ОТПОВИКУВАЊЕ ОД ДОЛЖНОСТА ВОНРЕДЕН И ОПОЛНОМОШТЕН АМБАСАДОР, ШЕФ НА КАНЦЕЛАРИЈАТА ЗА ВРСКИ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА ВО РЕПУБЛИКА ГРЦИЈА

I

Г-дин Благој Ханциски, се отповикува од должноста вонреден и ополномоштен амбасадор на Република Македонија, Шеф на Канцеларијата за врски на Република Македонија во Република Грција, со седиште во Атина.

II

Министерот за надворешни работи ќе го изврши овој указ.

III

Овој указ влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

Указ број 50
14 мај 2010 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
д-р **Горге Иванов**, с.р.